SEEK

Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo

Subvencionet për Efiçiencë të Energjisë në Kosovë

Subvencije za Energetsku Efikasnost na Kosovu

GFA CONSULTING GROUP

HPC

**<u>Memorandum Mirëkuptimi</u>**

**Ndërmjet**

Projektit **"Subvencionet për Efiçiencë të Energjisë në Kosovë - SEEK"**

**dhe**

**Komuna e Drenas**

**Lënda**

**DUKE PASUR PARASYSH që Projekti "SEEK – Subvencionet për Efiçiencë të Energjisë në Kosovë"** (në tekstin e mëtejmë: "Projekti") është një aktivitet në kuadër të Programit të Pragut për Kosovën të MCC-së i zbatuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës (**MFK) (EMENA-KOS18MCC5206),** që ka për qëllim të zvogëlojë konsumin e energjisë elektrike në sektorin e banimit duke ndarë subvencione dhe stimuj të tjerë ekonomikë për njësitë e banimit që të investojnë në masa të Efiçiencës së Energjisë (EE) dhe në Burime të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), nëpërmjet pakos ndërhyrëse Rinovimet për Efiçiencë në Njësitë e Banimit (HER).

**DUKE PASUR PARASYSH** që **Komuna e Drenasit** është e angazhuar në ndërmarrjen e hapave proaktivë për integrimin dhe forcimin e strukturave organizative të përshtatshme për përmirësimin e masave të EE/BRE në sektorin e banimit

**DUKE PASUR PARASYSH** që Projekti dhe Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejmë: "Palët") janë përcaktuar të punojnë së bashku në frymën e bashkëpunimit të mirë për të kontribuar në arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të Projektit. Ekipi konsultues i Projektit (Ekipi i Projektit) i përbërë nga GFA Consulting Group dhe HPC AG do të realizojnë aktivitetet teknike të Projektit në përputhje me standardet më të larta profesionale;

**DUKE PASUR PARASYSH** që, në planin afatgjatë, bashkëpunimi i avancuar ndërmjet Palëve do të kontribuojë në rritjen e efiçiencës së energjisë dhe në përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, në zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe do ta ndihmojë Qeverinë e Kosovës të avancojë drejt përafrimit me standardet mjedisore të BE-së.

**TANI, SI REZULTAT I KËSAJ,** duke u bazuar në mirëbesimin e dyanshëm dhe në frymën e bashkëpunimit miqësor, Palët kanë lidhur këtë Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejmë: "MM").

## Neni 1
## Objektivat e MM-së

1. Ky MM krijon kornizën për bashkëpunim midis Palëve në mënyrë që të sigurojë zbatimin efektiv të Projektit. Objektivi i përgjithshëm është inkurajimi i zbatimit të masave EE/BRE nëpërmjet pakos ndërhyrëse HER të Projektit dhe sensibilizimi i komunës/komunitetit për potencialin e investimit në njësi individuale të banimit, qofshin ato shtëpi ose apartamente individuale në kuadër të ndërtesave shumë-banesore, përmes rinovimeve dhe përmirësimit të EE-së.
2. Palët duhet të ofrojnë mbështetje të plotë për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit në përputhje me dispozitat e këtij MM-je, duke përfshirë edhe caktimin e burimeve të nevojshme institucionale, njerëzore dhe financiare për zbatimin e suksesshëm të këtij MM-je. Palët pajtohen të realizojnë përgjegjësitë e tyre përkatëse dhe të kenë marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi, komunikim të rregullt dhe konsultime në mënyrë që të përmbushet objektivi i Projektit.
3. Periudha e zbatimit të Projektit është shtator 2019 - shtator 2021.

## Neni 2
## Përgjegjësitë e Komunës së Drenasit

1. Komuna e Drenasit, në veçanti, duhet:

1.1 Të emërojë një ekip punues ose një përfaqësues komunal si "pikë të vetme të kontaktit" për bashkëpunim në zbatimin e aktiviteteve të Projektit. Lista e punonjësve të caktuar për bashkëpunim është dhënë në Shtojcën A dhe është pjesë përbërëse të këtij MM-je;
1.2 Të mbështesë procesin e mbledhjes së të dhënave në lidhje me HER dhe të mbështesë Projektin në identifikimin e njësive përfituese të banimit veçanërisht nga grupet e synuara të veçanta siç janë: familjet me të ardhura të ulëta që janë në skemën e ndihmës sociale, familjet që drejtohen nga gratë, minoritetet, familjet e cenuara (personat e moshuar, me aftësi të kufizuara ose me sëmundje kronike, familjet me fëmijë të vegjël);
1.3 Të ndihmojë në verifikimin e statusit socio-ekonomik të njësive të banimit përfituese nga Projekti;
1.4 Të sigurojë qasje në të gjitha dokumentet relevante të nevojshme për realizimin e detyrave të Projektit dhe të lehtësojë koordinimin midis departamenteve;
1.5 Komuna zotohet të thjeshtësojë procedurat që kanë të bëjnë me lejet ndërtimore dhe/ose të nxjerrë një vendim/pëlqim që rinovimet e tilla që kanë për qëllim investimin në mirëmbajtje të përjashtohen nga lejet ndërtimore, mundësisht me disa kushte të caktuara (nëse është e nevojshme, p.sh., që ngjyra e ndërtesës të mbetet e njëjtë ose të jetë e një skeme të caktuar të ngjyrave).
1.6 Të marrë pjesë me (20) % në bashkë-financimin (me grante të siguruara nga Komuna) e rinovimeve për efiçiencë të energjisë për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për bashkë-financimin e zbatimit të masave të EE-së gjatë rinovimit të shtëpive individuale ose të apartamenteve individuale në kuadër të ndërtesave shumë-banesore;
1.7 Të mbështesë me kontribut në natyrë/pjesëmarrje në ofrimin e shërbimeve siç janë inspektimi i punimeve gjatë zbatimit të rinovimit në përputhje me udhëzimet e siguruara nga ekipi i Projektit;
1.8 Të mbështesë shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e ngjarjeve promovuese për Projektin (duke përfshirë sigurimin e hapësirave pa kosto për Projektin, shpërndarjen e ftesave, shpalljet në media lokale, etj.);
1.9 Të mbështesë qytetarët të marrin pjesë në Projekt duke dorëzuar në emër të tyre aplikacione përmes interneti në objektet komunale;
1.10 Të mbështesë ekipin e Projektit në identifikimin e instaluesve lokalë për sigurimin e punëve ndërtimore dhe instalimin e sistemeve (izolimit, dritareve dhe dyerve të jashtme, sistemeve të ngrohjes, etj.) që do të ftohen në trajnimin e organizuar nga Projekti, me çka ata do të siguronin statusin e instaluesve të kualifikuar;

R.11 Mc

1.11 Të ndihmojë në identifikimin e grave lokale ndërmarrëse si përfituese potenciale të komponentit "Gratë Ndërmarrëse në Sektorin e Energjisë" (WEE) të Projektit.

**Neni 3**
**Përgjegjësitë e Projektit**

1. Në bashkëpunim të ngushtë me Komunën dhe nën mbikëqyrjen e Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës, Projekti duhet:

1.1 Të realizojë aktivitete informuese për ngritjen e vetëdijes në mesin e pronarëve të njësive të banimit për përfitimet nga EE në mënyrë që të sigurojë interesim të fuqishëm të pronarëve të njësive të banimit për të investuar në objektet e tyre duke zbatuar EE/BRE, duke e rritur kështu rehatinë dhe mbrojtur mjedisin;
1.2 Të mbledhë dhe të analizojë të dhënat e nevojshme për vlerësimin e projekteve të renovimit për njësitë individuale të banimit të zgjedhura paraprakisht;
1.3 Të lehtësojë marrëveshjet midis pronarëve të njësive individuale të banimit me instaluesit e kualifikuar (instaluesit e kualifikuar të masave EE/BRE) për rinovime dhe të mobilizojë financimin për të mbuluar kosotot e rinovimeve;
2. Projekti do të sigurojë një plan indikativ të zbatimit të aktiviteteve dhe do të pajtohet me Komunën për zbatimin e tij.

**Neni 4**
**Monitorimi dhe vlerësimi**

1. Palët do të konsultohen rregullisht për të monitoruar dhe shqyrtuar progresin e aktiviteteve të dakorduara.
2. Palët duhet të shkëmbejnë me njëra-tjetrën të gjitha informatat dhe dokumentet relevante, duke përfshirë raportet hulumtuese dhe çfarëdo informate tjetër që ka të bëjë me aktivitetet.

**Neni 5**
**Hyrja në fuqi**

Ky MM hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga të dyja palët.

R.LI Yk

**NË DËSHMI TË KËSAJ**, të poshtë-nënshkruarit, përfaqësues të emëruar në mënyrë të rregullt të Komunës së Drenasit dhe të Projektit, kanë nënshkruar dy ekzemplarë origjinalë të këtij MM-je në vendin(et) dhe në datën(at) e treguara më poshtë.

| **KOMUNA E DRENASIT** | **Projektit "Subvencionet për Efiçiencë të Energjisë në Kosovë - SEEK"** |
|---|---|
| Kryetari i Komunës: Ramiz Ladrovci | Udhëheqësi i Ekipit: Marko Kosir |
| Vendi: Drenas | Vendi: |
| Data: 29/01/2020 | Data: 29.1.2020 |

## SHTOJCA A: LISTA E PUNONJËSVE TË CAKTUAR PËR BASHKËPUNIM NGA PALËT

Komuna e Drenasit emëron përfaqësuesin(ët) e mëposhtëm për bashkëpunim në Projektin **"Subvencionet për Efiçiencë të Energjisë në Kosovë - SEEK"**:

| Nr. | **Përfaqësuesi(t) komunal** | **Pozita/Drejtorati** | **Kontakti (e-maili dhe telefoni)** |
|---|---|---|---|
| 1. | Dr.Sc. Nazmi Hasi | Menaxheri i projektit | Nazmi.hasi@rks-gov.net<br>044170727 |
| 2. | Shqipdon Zariqi | Zyrtar | Shqipdon.zariqi@rks-gov.net<br>049977883 |
| 3. | Granit Karaçica | Zyrtar | Granit.G.karaqica@rks-gov.net |

Projekti **"Subvencionet për Efiçiencë të Energjisë në Kosovë - SEEK"**: Ekspertët kyç (EK) dhe Ekspertët jo-kyç (EJK) për bashkëpunim me Komunën e Drenasit

| Nr. | **Përfaqësuesi(t) e Projektit** | **Pozita** | **Kontakti (e-maili dhe telefoni)** |
|---|---|---|---|
| 1. | Marijan Hohnjec | Udhëheqës i i pakos ndërhyrëse HER | marijan.hohnjec.jr@gmail.com<br>+383(0)45186209 |
| 2. | Luljeta Hoxha-Osmani | Udhëheqës i LST | hluljeta@gmail.com<br>+383(0)45516284 |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLOGOC MUNICIPAL
Pranuar 29.01.20
Nj. Org. 01 | Numër 400 | Shtojca 5247 | Vlera

**Memorandum of Understanding**

**between**

Project **"Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo - SEEK"**

**and**

**The Municipality of Drenas**

**Subject**

**WHEREAS, SEEK – Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo** (hereinafter referred to as "the Project") is an activity, under the **MCC** Threshold Program with implementing entity Millennium Foundation Kosovo **(MFK) (EMENA-KOS18MCC5206),** aiming to reduce electricity consumption in the residential sector by piloting subsidies and other incentives to households to invest in Energy Efficiency (EE) and Renewable Energy Sources (RES) measures, through Household Efficiency Retrofits (HER) intervention package.

**WHEREAS**, the **Municipality of Drenas** is committed to taking proactive steps in streamlining and strengthening organizational structures adequate to improve EE/RES measures under the residential sector.

**WHEREAS,** the Project and the Municipality of Drenas (hereinafter referred to as the "Parties") are determined to work together in a spirit of good cooperation to contribute to the achievement of the objectives and implementation of the Project's planned activities. Project's consultant team (the Project Team) composed by GFA Consulting Group and HPC AG, shall carry out technical activities of the Project in accordance with the highest professional standards.

**WHEREAS**, in the long-term, the enhanced co-operation between the Parties will contribute to increasing energy efficiency and the use of renewable energy sources, reducing environmental hazards and improved quality of life, and facilitate the Government of Kosovo in moving towards harmonization with EU environmental standards.

**NOW, THEREFORE,** on the basis of mutual trust and in the spirit of friendly cooperation, the Parties have entered into this Memorandum of Understanding (hereinafter referred to as MoU).

R. LI

## Article 1
## Objectives of This MoU

1. This MoU establishes the framework for cooperation between the Parties in order to ensure the effective implementation of the Project. The overall objective is to encourage the implementation of EE/RES measures through HER intervention package of the Project and to sensitize the municipality/community on the potential to invest in individual housing units, be it individual houses or individual apartments within multi-apartment buildings, by retrofit and EE improvements.
2. The Parties shall provide full support to the implementation of all Project activities in accordance with the provisions of this MoU, including the dedication of necessary institutional, human and financial resources for the successful implementation of this MoU. The Parties agree to carry out their respective responsibilities and to maintain close working relationships, regular communication, and consultations in order to achieve the Project objective.
3. The project implementation period is September 2019 - September 2021.

## Article 2
## The Municipality of Drenas responsibilities

1. The Municipality of Drenas in particular shall:

1.1 Appoint a municipal working team or a representative as "contact point" for cooperation in implementation of the Project's activities. The list of the assigned municipal staff is provided in Annex A thus representing an integral part of this MoU;
1.2 Support the data collection process related to HER and support the Project in identification of beneficiary households (HH) especially from particular target groups such as: low-income Social Assistance Scheme (SAS), women-headed, minorities, vulnerable HH (elderly, disabled or chronically ill people, families with young children);
1.3 Help verifying the socio-economic status of beneficiary HHs of the Project;
1.4 Provide access to all relevant documentation needed to conduct Project's tasks and facilitate municipal inter-departmental coordination;
1.5 The municipality commits itself to simplify the procedures related to construction permits and/or issue a Decision/Consent that such retrofit aiming at investment maintenance are excluded from permitting, possibly under certain conditions (if necessary, e.g. for instance that the color of the building remains the same or is from the defined color scheme).
1.6 Participate with (20) % co-financing (with grants ensured by Municipality) of EE-retrofits for some for instance SAS for co-financing the implementation of EE-measures during the retrofit of selected individual houses or individual apartments within multi-apartment buildings;
1.7 Support with in-kind contribution/participation with provision of services such as Inspection of works during the retrofit implementation in accordance with guidelines provided by the Project Team;
1.8 Support information dissemination and organization of promotion events for the Project (including provision of venues on a cost-free basis for the Project, distribution of invitations, announcements in local media, etc.);
1.9 Support the citizens by submitting online applications at Municipal premises for participation in the Project on their behalf;
1.10 Support the Project Team in the identification of local Installers for provision of construction works and installation of systems (insulation, external windows and doors, heating systems, etc.) to be invited to training organized by the Project, by which they would obtain a status of Qualified Installers;
1.11 Help in identification of local women entrepreneurs as potential Women Energy Entrepreneur (WEE) component beneficiary of the Project.

R.Ll

**Article 3**
**Responsibilities of the Project**

1. In close cooperation with the Municipality and under supervision of MFK, the Project shall:

1.1 Conduct outreach activities for raising awareness among home-owners on the benefits of EE so as to ensure strong interest of individual HHs to invest in their housing units by implementing EE/RES, thus increasing comfort and protecting the environment;
1.2 Collect and analyze all data needed for evaluation of retrofit projects for pre-selected individual HHs;
1.3 Facilitate agreement between home-owners of individual HHs with Qualified Installers (qualified installers of EE/RES measures) for retrofit and mobilizing the financing to cover the costs of the retrofit;
2. The Project will provide an indicative plan of implementation of activities and agree with municipality on its implementation.

**Article 4**
**Monitoring and Evaluation**

1. The Parties shall maintain regular consultations to monitor and review the progress of the agreed activities.
2. The Parties shall share with each other, all relevant information and documents, including research reports and any other information related to the activities.

**Article 5**
**Entry into force**

This MoU enters into force from the day of its signature by both parties.

R. LI

**IN WITNESS WHEREOF**, the undersigned, duly appointed representatives of the Municipality of Drenas and the Project, have signed two original copies of this MOU in the place(s) and on the date(s) herein below indicated.

| THE MUNICIPALITY OF DRENAS | Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo - SEEK |
|---|---|
| Mayor: Ramiz Ladrovci | Team Leader: Marko Kosir |
| Place: Drenas | Place: |
| Date: 29/01/2020 | Date 29.1.2020 |

## ANNEX A: THE LIST OF ASSIGNED STAFF BY THE PARTIES

The Municipality of Drenas appoints the following representative(s) for cooperation in the project "Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo - SEEK":

| SN | Municipal representative(s) | Position/Directorate | Contact (e-mail & telephone) |
|---|---|---|---|
| 1. | Dr.Sc. Nazmi Hasi | Menaxheri i projektit | Nazmi.hasi@rks-gov.net<br>044170727 |
| 2. | Shqipdon Zariqi | Zyrtar | Shqipdon.zariqi@rks-gov.net<br>049977883 |
| 3. | Granit Karaçica | Zyrtar | Granit.g.karaqica@rks-gov.net |

The project "Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo - SEEK" Key Experts (KE) and Non Key Experts (NKE) to cooperate with the Municipality of Drenas

| SN | Project representative(s) | Position | Contact (e-mail & telephone) |
|---|---|---|---|
| 1. | Marijan Hohnjec | HER IP Leader | marijan.hohnjec.jr@gmail.com<br>+383(0)45186209 |
| 2. | Luljeta Hoxha-Osmani | LST Leader | hluljeta@gmail.com<br>+383(0)45516284 |